

**RREGULLORE E BRENDSHME
E PROGRAMIT
“DOKTOR I SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE”**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti i rregullores

Rregullorja e brendshme (në vijim “rregullorja”) e programit të studimit “Doktor i shkencave albanologjike” (në vijim DShA) vendos rregullat normative të funksionimit të këtij programi dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e këtij cikli të tretë të studimit. Rregullorja përcakton misionin e Programit të Studimit të DShA-së, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të saj, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të kandidatëve, të bashkëpunëtorëve; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e kandidatëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikime, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Programit të Studimit DShA-së

Neni 3

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 864, datë 05.12.2007 “Për hapjen e programeve të Doktoratës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe për përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, (i ndryshuar), si dhe Udhëzimit Nr. 5, datë 22.10.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Mbi këtë bazë ligjore dhe në projektrregulloren e Këshillit të Profesorëve të FEShSh-së, Këshilli Shkencor i këtij fakulteti në miratoi këtë rregullore.

Neni 4

Subjektet



Subjektet e kësaj rregulloreje janë organet drejtuese, personeli akademik dhe administrativ, Këshilli i Profesorëve, kandidatët-studentë të Programit të Studimit të DShA-së dhe bashkëpunëtorët e këtij programi.

KREU II

STATUSI, MISIONI DHE VEPRIMTARIA E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË

Neni 5

Statusi i programit

- 5.1. Dekani i FEShSh-së është drejtuesi i të gjitha studimeve të ciklit të tretë brenda këtij fakulteti dhe ka në varësi të gjitha komisionet që drejtojnë komisionet përkatëse;
- 5.1. Programi i Ciklit të Tretë është njësi përbërëse në strukturën akademike të FEShSh-së. Përmbarëvajtjen e veprimtarisë së Programit të studimit DShA kanë përgjegjësitë përkatëse Dekani i FShSh-së dhe Këshilli i 7 profesorëve, i ngritur me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në RSh” i ndryshuar.
- 5.2. Programi i Studimit DShA është Cikli i Tretë i Studimeve Universitare, niveli më i lartë i shkollimit universitar dhe i kërkimit shkencor të kandidatëve të regjistruar në të.
- 5.3. Programi i studimit të doktoratës organizohet brenda projektit të madh kërkimor, didaktik, kulturor, kërkimi të pavarur që ka Universiteti i Gjirokastrës (UGj) që realizohet në koordinimin me zhvillimin e dokumentuar të veprimtarisë së kërkimit të FEShSh-së dhe të fakulteteve të tjera.
- 5.4. Objektivat formuese të Programit të Studimit DShA janë të gjera, të motivuara dhe të lidhura me orientimet shkencore në fushën e albanologjisë.
- 5.5. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve të Ciklit të Tretë në fushën e shkencave pedagogjike, studenti fiton gradën: “Doktor i shkencave albanologjike”.
- 5.6. Studimet e doktoratës janë konceptuar si studime të fundit, si stacion i fundit i karrierës së njohur në fushën e shkencave albanologjike. Në përfundim të këtyre studimeve, doktori i shkencave albanologjike mund të punojë si i pavarur ose mund të mbikëqyrë a drejtojë specialistë të fushave të të albanologjisë: gjuhësi, letërsi, histori e etnografi shqiptare.

Neni 6

Misioni i programit

- 6.1. Programi i studimeve të doktoratës në fushën e shkencave albanologjike është ndërtuar në varësi të faktit se ku do të punësohet doktori i ardhshëm i shkencave albanologjike. Ai do të punojë si punonjës shkencor, kërkues në institucion kulturore e shkencore, pedagog në universitet, punonjës në media etj.
- 6.2. Fokusi i studimeve të ciklit të tretë është kërkimi shkencor, i cili ofrohet në atë masë sa kërkohet edhe në praktikë. Grada shkencore “doktor” synon të përgatisë pedagogun që të funksionojë në mënyrë të pavarur si kërkues shkencor, si drejtues i kërkimit shkencor.



Misioni i studimeve të doktoratës në fushën e shkencave albanologjike synon:

- a. Të përgatisë specialistë të shkencave albanologjike të përgatitur me standartet më të larta teorike e praktike të mundshme për Shqipërinë.
- b. Të mbështesë kultivimin e vlerave të të mësuarit evropian në Shqipëri.
- c. Të ndihmojë shoqërinë shqiptare në procesin e integrimit evropian.

Neni 7

Objektivat e studimeve

Studimet në këtë program studimi synojnë që studentët të aftësohen që:

- 7.1. Të zoterojnë një kapacitet për t'u përfshirë në kërkim shkencor të pavarur, në drejtimin e kërkimit shkencor dhe në vlerësimin e kërkimit shkencor për përmirësimin e nivelit të zotërimit dhe përdorimit të gjuhës, si dhe të përshkrimit sa më të mirë të saj përmes mjeteve teknologjike.
- 7.2. Të ketë aftësi për përmirësimin e mirëqenies vetjake e shoqërore nëpërmjet qasjes historike, gjuhësore dhe etnogjuhësore, letrare në fushën e letrave shqipe dhe të zbatimit të njohurive.
- 7.3. Të zoterojnë këndvështrime albanologjike që kontribuojnë në përmirësimin e zotërimit dhe përdorimit të gjuhës së individeve dhe grupeve, rritjes së aftësive dhe të kapaciteteve për progres arsimor e zhvillim vetjak përmes kompetencës gjuhësore e historike.
- 7.4. Të zoterojnë këndvështrime gjuhësore bashkëkohore që kontribuojnë në aftësimin për të luajtur rol drejtues në përhapjen e dijes albanologjike përmes mësimdhënies dhe trajnimeve.
- 7.5. Të zoterojnë këndvështrime historike, etnokulturore bashkëkohore, që kontribuojnë në aftësimin për të luajtur rol drejtues në promovimin e vlerave historike dhe kulturore të vendit tonë.

Neni 8

Fushat e studimit

- 8.1. Studimet e doktoratës në fushën e shkencave albanologjike mund të realizohen në këto drejtime: (një tematikë e gjërë jepet në një listë në vendin e caktuar të këtij drafti)

A. PROFILI HISTORI

- Elementet përbërës të fushës së historisë së shqiptarëve;
- Problematika të aspekteve të ndryshme të ngjarjeve e dukurive më thelbësore të historisë lokale e kombëtare, si edhe evidentimi i kontributeve të personaliteteve të shquara historike;
- Problemët e evidentimit dhe vënies në eficiencë të vlerave të trashëgimisë historike;
- Nëpërmjet tezave të doktoratës synohen zbatime konkrete, dimensionet sociale dhe vlerat aplikative të studimeve në fushë të historisë kombëtare e lokale;
- Zbatime të reja për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të shoqërive turistike, për përfshirjen më programe e guida të vlerave të trashëgimisë historike në Shqipëri.



B. PROFILI GJUHËSI

- Gramatika transformuese e gjenerative në fushë të shqipes
- Gramatika e varësisë në fushë të shqipes
- Gjuhësia e mediave dhe studime të gjuhës së mediave në fushë të shqipes
- Gramatikë e gjuhës së folur në fushë të shqipes
- Dialektologji e gjuhës shqipe
- Sociolinguistikë
- Etnolinguistikë
- Semantikë e fjalës, fjalisë, tekstit, ligjërimit
- Semantika gjenerative në fushë të shqipes
- Semantika strukturore në fushë të shqipes
- Onomasiologji e shqipes
- Leksikografia: fjala dhe gjuha
- Analiza e ligjërimit në fushë të shqipes
- Politika gjuhësore, ekologjia gjuhësore në fushë të shqipes
- Gjuhësia e internetit në fushë të shqipes
- Prirje të sotme të gjuhës së shqiptare
- Programimi dhe korrigjimi në kompjuter në fushë të shqipes
- Gjuhësia joverbale
- Fonetikë historike e gjuhës shqipe
- Gjuhësi ballkanike

PROFILI LETËRSI

- Proza e shkurtër shqiptare pas gjysmës së dytë të shekullit të kaluar: autorë të spikatur, vëllime me tregime dhe analiza krahasuese, kontekste socio-kulturore, teknika rrëfimi dhe procedime letrare.

- Letërsia humoristike shqipe pas gjysmës së dytë të shekullit të kaluar: Çështje të narracionit satirik përmes analizave krahasimtare te teksteve mes tyre.

- Individualitetet poetike të autorë dhe letërsi disidente, kontekste socio-politike, poezia e antikonformizmit dhe e refuzimit. Interpretime dhe analiza të vëllimeve poetike dhe literaturës kritiko-letrare, historike e memorialistike.

Poezia shqipe në mijëvjeçarin e ri: realitetë procesesh krijuar, autorë përfaqësues, prirje gjuhësore e stilistikore, tendenca përjetimesh psikologjike, përpjekje për profilizime dhe individualitete letrare, interpretime dhe analiza vëllimesh poetike, krahasime dhe konkluzione.



- Shtypi i shkruar në Gjirokastër pas Luftës së Dytë: gazeta "Pararoja", struktura grafike dhe tipologjike, sfondi historik, kategoritë publicistike, gjuha dhe stilistika e shprehjes dhe komunikimit, lloje letrare në gazet

- Psikoanaliza dhe ndikimi i saj në letërsinë shqiptare. Epoka e neorealizmit dhe ndikimi i tij në kulturën italiane

Letërsia moderne italiane dhe receptimi nga lexuesi shqiptar

- Zhvillime të letërsisë botërore në dekadat fundit veçori e specifika të saj në Evropë, në kushtet e komunikimit modern e rënies së "perdes së hekurt".

- Vështrim krasues mbi eposet e poujve të Ballkanit. Arti i përgjithësimit në fjalët e urta popullore.

Frazeologjia popullore në letërsinë artistike. Koncepti popullor për të bukurën në këngët lirike.

Ligjërimi ungjillor dhe kodet etnojuridike të shqiptarëve. Prania kulturore hebraike në traditën shqiptare.

Eposi shqiptar dhe eposi pers: vështrim krasues. Eurokultura dhe identiteti europian i shqiptarëve.

Folklori shqiptar në vështrimin e të huajve

Neni 9

Veprimtaria e programit të studimit

Aspektet kryesore të veprimtarisë së Programit të Studimit për doktoratë janë: mësimdhënia, kërkimi, dialogu europian dhe botimet.

7.1. Veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve dhe të programeve mësimore bashkëkohore të bazuara në modelet e shkollave analoge evropiane. Programet përbajnjë veprimtari didaktiko-shkencore të formimit të thelluar teorik, seminareve me kualifikim të lartë, stazhit apo praktikave pranë strukturave të kualifikuara etj.

7.1.1. Ndjekja e kurseve të studimit nënkuption marrjen e disa lëndëve, një pjesë të detyruara dhe pjesa tjeter me orientim të Këshillit të Profesorëve (KP).

7.1.2. Angazhimi në mësimdhënie me kohë të pjesshme në universitet nënkuption detyrimin që studenti doktorant të jepë mësim në Ciklin e Parë dhe të Dytë universitar, në fushat për të cilat kryhen kërkimin.

7.2. Veprimtaria kërkimore është e orientuar kryesisht në studimin e çështjeve të integrimit të të mësuarit evropian në vendin tonë dhe realizohet nëpërmjet disertacioneve dhe projekteve të kërkimit. Kjo veprimtari është planifikuar që të lidhet me objektivat formuese të programit të studimit të doktoratës dhe të janë të kontrolluara. Programet përfshijnë kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë përpunimin e tezës së doktoratës, rezultatet dhe mbrojtjen e suksesshme që të çojnë në marrjen e gradës "Doktor".



7.2.1. Studimi i literaturës nënkuption studimin e të gjithë literaturës së mundshme në gjuhë të huaj, e cila nënkuption kontributet më të njohura të autorëve që kanë kryer studime në këtë fushë në të cilën kërkon dhe studenti doktorant.

7.2.2. Studimet në terren nënkuptojnë kërkimin në terren në lidhje me fushën e studimit dhe përfshin analizën e të dhënave që ka grumbulluar disertanti në kuadrin e kërkimit specifik që realizon.

7.3. Dialogu evropian realizohet nëpërmjet Prezantimit në konferanca, sesioneve shkencore, seminareve dhe veprimtarive të tjera me qëllim që të sigurojë informacion bashkëkohor dhe të ndihmojë në ngritjen e interesit për çështje të integrimit evropian të shkollës shqiptare.

7.4. Veprimitaria botuese kryhet në përshtatje me fushën e studimit dhe nënkupton kalimin e produkteve të punës së studentit doktorant në një provë publike përpëra se të gradohet.

Neni 10

Parimet

8.1. Programi i Ciklit të Tretë për DShA e zhvillon veprimitarinë e tij në bazë të parimeve: të lirisë akademike, të autonomisë institucionale, të cilësisë, të efektshmërisë, të dobisë e përsigurimit.

8.1.1. *Liria akademike* nënkupton mungesën e ndërhyrjes nga jashtë, të censurës dhe të barrierave në praktikën e veprimitarisë akademike. Ajo vështrohet si një parakusht për mendimin kritik, krijues si dhe përvetësimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual.

8.1.2. *Autonomia institucionale* i referohet shkallës së vetëregullimit dhe të pavarësisë administrative për përbushjen e misionit të këtij programi. Bazuar në këtë parim FEShSh-ja për programin DShA:

- a) miraton vetë strategjinë e zhvillimit kërkimor;
- b) miraton vetë programet mësimore;
- c) ngre, përkrah dhe ndihmon Këshillin e Profesorëve për realizimin e misionit të tij;
- d) ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare të fushës së studimeve historike, gjuhësore e albanologjike;
- e) ka të drejtë të bashkëpunojë me fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e studimeve albanologjike, historike dhe gjuhësore dhe në procesin e integrimit evropian të universiteteve dhe institucioneve shkencore shqiptare;
- f) ka të drejtën e përzgjedhjes së personelit akademik që do të punojë në të;
- g) ka të drejtën e përdorimit të ndërtesave dhe të pasurive të tjera të dhëna nga *Universiteti i Gjirokastër* ose dhurues të ndryshëm sipas legjislacionit në fuqi.

8.1.3. Parimi i cilësisë nënkuption zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, të infrastrukturës si në aspektin e kërkjesave edhe të pritshmërie, të cilat duhet të plotësohen për të arritur idealin e përsosmërisë. Zbatimi i parimit të cilësisë nënkuption realizimin e vlerësimit teorik.



brendshëm, të vetëvlerësimit, të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit duke synuar përmirësimin, ndryshimin, përparimin dhe njohjen zyrtare të cilësisë së shkollës.

- 8.1.4. *Efektshmëria* nënkupton funksionimin në një mënyrë të tillë që çon drejt realizimit të qëllimeve dhe objektivave të dëshiruara. Ky parim kërkon që gjërat të bëhen sipas një strategie të parashikuar.
- 8.1.5. Parimi i *dobisë e përfitimit* nënkupton që programi të arrijë rezultate të mira me kosto të pranueshme për shoqerinë, të përdorë burimet njerëzore, materiale dhe mjetet në mënyrë optimale.

KREU III ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I STUDIMEVE DOKTORALE

Neni 11

Struktura e shkollës

Programi i studimeve të ciklit të tretë për “Doktor i shkencave albanologjike“ ka këtë strukturë organizative:

1. Dekani i FEShSh-së
1. Këshilli i Profesorëve
2. Përgjegjësi i programit DShA (koordinatori) i barasvlershëm me përgjegjësin e departamentit
3. Udhëheqësi shkencor i studentit doktorant

Këto njësi drejtuese e realizuese kanë nën varësi:

1. Personelin akademik
2. Personeli ndihmës, Administrata
3. Komisionet që ngrihen sipas nevojës

Neni 12

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Ciklit të Tretë janë:

- a) Dekani i FEShSh-së,
- b) Departamenti i gjuhës shqipe, Departamenti i letërsisë, Departamenti i historisë,
- c) Këshilli i Profesorëve,
- d) Udhëheqësi shkencor.



Këta kontrollojnë kolegialisht gjithë veprimtarinë akademike, administrativë dhe financiare të studimeve të Ciklit të Tretë dhe marrin vendime për probleme të rëndësishme.

KREU IV

HAPJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS

Neni 11

Kushtet për hapjen e programit të studimit të doktoratës

Çdo departament ose grup mësimor-kërkimor i FEShSh-së mund të formulojë propozimin për hapjen e programeve të studimit të doktoratës nëse departamenti dhe FEShSh-ja plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) Ka personel akademik me titull: Profesor, Profesor i asocuar dhe Doktor (PHD) të fituar në një universitet perëndimor, i cili ka së paku 2 vjet përvojë mësimore-kërkimore pas doktoratës; 60 % e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, i angazhuar në kërkim dhe me këta tituj akademikë.
- b) Ka numrin e nevojshëm të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit dhe në kryerjen e detyrave përkatëse didaktike;
- c) Ka strukturë të posaçme operative dhe kërkimore për veprimtaritë e parashikuara nga program i studimit të doktoratës (laboratori, biblioteka, studime etj.).
- d) Ka burime financiare mbështetëse;
- e) Bashkëpunon me fakultete të universiteteve të huaja apo me subjekte publike e private të kërkimit që garantojnë programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës.
- f) Ka përcaktuar mënyrat e verifikimit të veprimtarisë kërkimore apo krijuese të studentëve, veçanërisht me përgatitjen e tezës së doktoratës.

Neni 12

Propozimi për hapjen e programit të doktoratës

a.1. Përgjegjësi i departamentit (ose koordinatori i caktuar nga Kryetari i Këshillit të Profesorëve) nëpërmjet Dekanit i paraqet Këshillit të Profesorëve të FEShSh-së propozimin për hapjen e programit të studimit të doktoratës ose propozimin për riorganizimin e një programi ekzistues.

a.2. Ky propozim formulohet sipas kërkesave e formularëve të paraqitura në pjesën "shtojcë" të parashikuara nga Udhëzimi nr. 5 datë 22.01.2008 të Ministrisë së Arsimit e Shkencës (MASH). Propozimi duhet të shoqërohet edhe me modelet e kontratave të ndryshme të bashkëpunimit, të vlerësimit yjetor të



punës së kryer të studentit, të platformës së doktoratës dhe të autoreferatit sipas specifikave të çdo fakulteti.

Neni 13

Shqyrtimi i propozimeve nga KP dhe përcjellja në Senatin Akademik të UGj-së

KP brenda një muaj nga data e paraqitjes së propozimit e shqyrton atë në se përputhet me kërkesat e parashikuara në Ligji dhe aktet nënligjore. Nëse KP-ja miraton propozimin/et dhe udhëheqësin/it shkencor të propozuar përcjell në Rektorat nëpërmjet Dekanit të FEShSh-së, që të bëhet shqyrtimi përfundimtar në Senatin Akademik. Propozimi i KP duhet të përbajë:

- a) Fushën shkencore dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës, i cili duhet t'i referohet një sektori disiplinor ose ndërdisiplinor me relacionin përkatës sqaues;
- b) Programin e studimit të miratuar sipas rregullave të parashikuara në Statut bashkë me mënyrën e organizimit didaktik dhe shkencor të programit, planin mësimor përfazën e thellimit teorik si dhe parashikime përiudhat e qëndrimit në institucionë të huaja kërkimore;
- c) Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;
- d) Tarifën e studimit për çdo student e argumentuar si dhe burime të tjera financimi për programin/et e doktoratës, nëse ka të tillë;
- e) Parashikimin për numrin maksimal të studentëve që mund të regjistrohen çdo vit në programin/et e doktoratës (jo më pak se tre);
- f) Personeli akademik që do të mbulojë realizimin e disciplinave teorike të studimit të doktoratës, udhëheqjen e disertantëve sipas titullit apo gradës shkencore. Nëse në ekipet mësimore përfshihen personel akademik i ftuar, ai duhet të jetë i miratuar nga Këshilli i Profesorëve të FEShSh-së;
- g) Të dhëna për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit, departamenti që drejton administrativisht programin e doktoratës kur kjo është ndërdisiplinore;
- h) Të dhëna mbi përvojat e mëparshme të strukturave në formimin pasuniversitar, nëse ka pasur;
- i) Bashkëpunimet shkencore për realizimin e programit të studimit apo të pjesëve të tij me institucionë të tjera kërkimore ose ente publike apo private.
- j) Njësinë bazë apo departamenti propozues i programit të studimit të doktoratës që garantojnë infrastrukturën e nevojshme, ndërtimore e laboratorike përvillimin e programit;
- k) Modelin e diplomës.

Neni 14

Përcjellja e propozimit nga Rektorati

Rektorati i UGj-së i përcjell propozimet për programin/et e doktoratës në Senatin Akademik, i cili i shqyrton ato, brenda një muaji nga dita e paraqitjes.



Neni 15

Miratimi në Senatin Akademik dhe dërgimi në MASH

Pas miratimit në Senatin Akademik, secili program doktorate (i ri ose i riorganizuar) bashkë me formularët përkatës, të nënshkruar nga Dekani i FEShSh-së, përgjegjësi i departamentit dhe koordinatori i programit, si dhe nga Rektori i UGj-së, i dërgohet MASH për procedura të mëtejshme.

Neni 16

Dokumentacioni që dërgohet në MASH

Për hapjen e programit të doktoratës në fushën e studimeve albanologjike, FEShSh-ja, nëpërmjet UGj-së duhet të paraqesë në MASH kërkesën për hapjen e saj të shoqëruar me dokumentacionin përkatës:

- a) Fushën shkencore dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës, i cili duhet t'i referohet një sektori disiplinor ose ndërdisiplinor me relacionin përkatës svarues.
- b) Programin e studimit të miratuar sipas rregullave të parashikuara në statut bashkë me mënyrën e organizimit didaktik dhe shkencor të programit, planin mësimor për fazën e thellimit teorik si dhe parashikime për periudhat e qëndrimit në institucion të huaja kërkimore.
- c) Afatet kohore të realizimit të programit të studimit.
- d) Tarifën e studimit të argumentuar për çdo student si dhe burime të tjera financimi për programin/et e doktoratës, nëse ka të tillë;
- e) Parashikimin për numrin maksimal të studentëve që mund të regjistrohen çdo vit në programin/et e doktoratës (jo më pak se tre).
- f) Personeli akademik që do të mbulojë realizimin e disiplinave teorike të studimit të doktoratës, udhëheqjen e disertantëve sipas titullit apo gradës shkencore. Nëse në ekipet mësimore përfshihen personel akademik i ftuar, ai duhet të jetë i miratuar nga Këshilli i Profesorëve të FEShSh-së.
- g) Të dhëna për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit, departamenti që drejton administrativisht programin e doktoratës kur kjo është ndërdisiplinore.
- h) Të dhëna mbi përvojat e mëparshme të strukturave në formimin pasuniversitar, nëse ka pasur.
- i) Bashkëpunimet shkencore për realizimin e programit të studimit apo të pjesëve të tij me institucionë të tjera kërkimore ose ente publike apo private.
- j) Njësinë bazë apo departamenti propozues i programit të studimit të doktoratës, që garantojnë infrastrukturën e nevojshme, ndërtimore e laboratorike për zhvillimin e programit.
- k) Modelin e diplomës.
- l) Rregulloren për organizimin e programit të studimit të doktoratës në fushën e studimeve albanologjike.

Neni 17

Miratimi përfundimtar i programit të doktoratës



Programi i studimit të doktoratës quhet i miratuar zyrtarisht kur Këshilli i Ministrave miraton propozimin përkatës të MASH-it.

KREU V
KËRKESAT THEMELORE DHE PROCEDURAT E
REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE

Neni 18

Udhëheqësi shkencor

- 18.1. Udhëheqësi shkencor për studentin pjesëmarrës në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose të ketë të paktën gradën “Doktor” (PHD) të fituar në një universitet perëndimor.
- 18.2. Numri i studentëve që mund të udhëheqë njëkohësisht një udhëheqës shkencor përcaktohet për çdo rast nga KP i FEShSh-së.

Neni 19

Kriteret që duhet të përbushin studentët kandidatë

Kandidati që kërkon të ndjekë programin e studimeve “Doktor” në fushën e shkencave albanologjike duhet të përbushë kriteret e mëposhtme:

- a) Të zoterojë një diplomë universitare në fushën e kërkuar: të zoterojë një Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose një Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, ose një Diplomë të sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm të fituar jashtë vendit dhe e njojur nga organet kompetente.
- b) Të zoterojë një Diplomë ShPU-je e barasvlershme me diplomën Master i Nivelit të Dytë.
- c) Të zoterojë një diplomë “Master i nivelit të dytë” ose “Master i shkencave”
- d) Të ketë notë mesatare të studimeve universitare në nivelin e parë dhe të dytë, tetë e lart.
- e) Të ketë dëshmi ndërkombëtare zotërimi të gjuhës angleze (së paku niveli ndërkombëtar C1), ose të pajiset me këtë dëshmi deri në prag të mbrojtjes së disertacionit.
- f) Të shprehë qartë qëllimin e ndjekjes së studimeve në programin e doktoratës.
- g) Të jetë i rekomanduar nga dy persona të cilët i njohin aftësitë akademike, profesionale, kërkimore dhe vetjake të kandidatit dhe që gjëzojnë titull shkencor.
- h) Të zbatojë standarde shkencore e etike.

Neni 20

Dosja e konkurrentit



Në dosjen e dokumentacionit të pranimit të bëjnë pjesë:

1. Kërkesa e studentit kandidat për miratimin e programit të studimit të doktoratës, në të cilët theksohet propozimi për temën dhe për udhëheqësin shkencor.
2. Formular i plotësuar i kërkesës.
3. Fotokopje e kartës të identitetit ose pasaportës biometrike, të noterizuara.
4. Biografi profesionale (CV)
5. Diplomë universitare e Nivelit të parë e të Dytë me listën e notave, e noterizuar dhe e shoqëruar me origjinalen.
6. Diplomë ShPU, Master i Nivelit të Dytë, "Master i shkencave" si dhe certifikata të kualifikimeve të ndryshme pasuniversitare, të gjitha me listën e notave, të noterizuara dhe të shoqëruara me origjinalen.
7. Dëshmi ndërkombëtare (së paku niveli C1) për nivelin e zotërimit të gjuhës angleze.
8. Dëshmi të një gjuhe tjeter të huaj nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të UT-së, e noterizuar e shoqëruar me origjinalen.
9. Listë botimesh e shoqëruar me fotokopje të kopertinave të botimeve ose të abstrakteve të tyre.
10. Dy letra rekomandimi, të dhëna nga profesorë ose profesorë të asociuar, secila e mbyllur në zarf dhe e firmosur nga rekomanduesi.
11. Vendim i departamentit të gjuhësisë, departamentit të letërsisë, departamentit historisë për propozimin e temës.
12. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin.
13. Platforma e disertacionit.
14. Plani i punës i ndarë në vite.
15. Vërtetim i qendrës së baniimit.
16. Deklaratë vetjake për përballimin e shpenzimeve të studimeve.
17. Tri fotografji me format pasaporte.
18. Fletëpagesa e taksës së regjistrimit për konkurrim.

Neni 21

Pranimi i dokumentacionit

- a) Të gjitha dokumentet për konkurrim duhen dorëzuar nga vetë i interesuari te zëvendësdekani i Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore për drejtimin shkencor. Zëvendësdekani pasi kontrollon plotësinë ose jo të dosjes e dërgon për shqyrtim paraprak te përgjegjësi i departamentit të gjuhës shqipe, përgjegjësit të departamentit të letërsisë ose atij të historisë, sipas profilit të temës së propozuar. Nuk pranohet dërgimi i dokumenteve me e-mail, fax ose me postë.



- b) Brenda një jave dosja shqyrtohet në departament. Dosja e plotësuar me shkresën përcjellëse të Dekanit të FEShSh-së përcillet për shqyrtim e miratim në Këshillin e Profesorëve (KP).

Neni 22

Procedura e përgjedhjes së kandidatëve dhe e komunikimit të vendimit

- a) Procedura e përgjedhjes zgjat një javë:
- b) Për përgjedhjen e parë të kandidatëve, Këshilli i Profesorëve vepron si Komision Teknik i cili ka për detyrë të vlerësojë përshtatshmërinë e dokumentacionit me kriteret e pranimit dhe të vlerësimit teknik dhe përgatitjen e listës së kandidatëve që kanë dokumentacion të plotë dhe të rregullt.
- c) Më pas Këshilli i Profesorëve vepron si Komisionin Akademik, i cili ka për detyrë të përgjedhë nga kandidatët e paraqitur si të përshtatshëm ata që kanë treguesit më të lartë duke i vlerësuar treguesit e tyre sipas kritereve të pranimit dhe kritereve të vlerësimit akademik.
- d) Kandidatët e përgjedhur i nënshtronen një interviste nga Këshilli i Profesorëve. Intervista zhvillohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Këshilli i vlerëson kandidatët në bazë të kritereve të caktuara.
- e) Bazuar në rezultatet e tri vlerësimeve, Këshilli i Profesorëve përgjedh kandidatët fitues të programit të studimit të doktoratës. Fitues shpallen kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.

Neni 23

Komunikimi i vendimit

Dekani i FESHH-së në bazë të vendimit të Këshillit të Profesorëve shpall listat e fituesve, duke i dërguar secilit kandidat një letër me njoftimin e vendimit të pranimit, të mospranimit ose të përfshirjes në listën pritëse.

KREU VI

PUBLIKIMI

Neni 24

Publikimi

Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursen e pranimit në programet e studimit të doktoratës, publikohen në organet e medies së shkruar dhe në faqen zyrtare të çdo njësie kryesore, të paktën një muaj përpresa mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.



KREU VII
KËRKESAT THEMELORE TË PUNËS
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS

Neni 25

Kushtet për botime e referime të studentët

Gjatë periudhës së studimeve e kërkimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, student duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) Të ketë realizuar së paku tri referime ose paraqitje shkencore, nga të cilat një referim ose paraqitje të jetë mbajtur në një veprimtari shkencore/profesionale ndërkombëtar (simposium, konferencë, kongres) i pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në “proceedings” të indeksuar me kod ISBN-je.
- b) Të ketë botuar, si autor i parë, së paku, tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku, njëri prej artikujve duhet të jetë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore ndërkombëtare me bord editorial.
- c) Të ketë paraqitur në KP të FEShSh-së dosjen e plotë që përbën edhe disertacionin e përfunduar, me një përbledhje të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Pas shqyrtimit të dosjes, KP i përcjell Dekanit vendimin për vazhdimin ose jo të procedurës së mbrojtjes së doktoratës. Kur KP vendoz pozitivisht, ai i propozon Dekanit edhe jurinë për mbrojtjen e doktoratës.

Neni 26

Analiza ndaj studentit disertant

Të paktën një herë në vit, koordinatori i programit dhe departamenti shqyrton ecurinë e punës së studentit disertant për doktoratë. Nëse nga këto analiza arrihet në përfundimin se disertanti nuk është i aftë për të vazhduar më tej programin, nëpërmjet dekanatit, mund t'i propozojë KP çregjistrimin e tij nga programi.

KREU VIII
TË DREJTAT DHE DETYRAT E STUDENTIT TË DOKTORATËS

Neni 27

Statusi i studentit

- a) Kandidati fitues i konkursit të pranimit ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik për të cilin konkurroi nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të FEShSh-së brenda afaleve të



parashikuara. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit të programit DShA dhe të gjitha të drejtat që burojnë prej tij.

- b) Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës ose me përjashtimin e personit nga universiteti.

Neni 28

Të drejtat e studentëve

Studentët e programit DSHA kanë këto të drejta:

- a) Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluara qartë dhe të përligjura në aspektin akademik.
- b) Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik.
- c) Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon të kenë për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e shkollës.
- d) Të përdorë pajisjet e shkollës, sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në veprimtarinë e tij shkencore, bibliotekën dhe internetin;
- e) Të paraqesin pikëpamjet e tyre pa frikë nga ndëshkimi.
- f) Të përfaqësohen në organet drejtuese të UGj-së.
- g) Të marrin pjesë në vlerësimin e veprimtarisë së shkollës.
- h) Të refuzojnë të kryejnë detyra që nuk lidhen me zhvillimin akademik dhe profesional.
- i) Të strehohet në konviktin studenti nëse nuk kanë vendstrehim tjeter.

Neni 29

Përgjegjësitë e studentëve

Studentët e programit DSHA kanë këto përgjegjësi:

- a) Të njohin dhe të zbatojnë Rregulloren e Programit DShA, FEShSh-së dhe të Universitetit të Gjirokastrës, kërkesat e planit dhe të programeve mësimore dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt FEShSh-ja nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- b) Të sillen në një mënyrë të pjekur, profesionale, qytetare në tërë ndërveprimet në FEShSh dhe në universitet me drejtuesit, personelin akademik dhe administrative, studentët e tjera dhe bashkëpunëtorët e shkollës.
- c) Të përbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve mësimore, të praktikës dhe të tezës.
- d) Të kontribuojnë në zhvillimin e shkollës dhe krijimin e një klime pozitive në shkollë.



- e) Të respektojnë kohën e pedagogëve.
- f) Të paguajnë taksën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit në afatet e caktuara.
- g) Të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të shkollës nga ana e tyre, dëmi material që mund t'i shkaktojnë shkollës, zhdëmtohet në masën që e gjykon dekanati.

Neni 30

Përgjegjësitë e FEShSh-së për studentët

- a) FEShSh-ja u jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me rregulloren e shkollës, strategjinë e zhvillimit të shkollës, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregullat e vlerësimit, rregullat e praktikës, rregullat e mbrojtjes së mikrotezës, tarifën e shkollimit.
- b) Respekton të gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, kërkimin, vlerësimin.
- c) Nxit studentët të marrin pjesë në veprimtaritë e shkollës dhe të universitetit.
- d) U vjen në ndihmë studentëve në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e planit mësimor.
- e) Krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në dispozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

KREU IX

PËRGJEGJËSITË E UDHËHEQËSIT SHKENCOR, KOORDINATORIT DHE STAFIT AKADEMIK E NDIHMËS

Neni 31

Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor

- a) Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së disertacionit.
- b) Të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar.
- c) Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrije standarde të larta të kërkimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Nëse udhëheqësi vëren se kandidati ka mangësi në shkrinin akademik, ai i paraqet atij kërkesën për të ndjekur kurse të caktuara që mund t'i ndihmojnë kërkimin, zotërimin e metodave dhe të teknikave shkencore. Udhëheqësi e ndihmon kandidatin të përmirësojë stilin,



por nuk i kërkohet atij që të bëjë redaktimin e materialit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë kandidatin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.

- d) Të mbajë takime të rregullta me kandidatin (të paktën 2-3 orë në javë) për të dhënë këshilla dhe për të qenë në dijeni të ecurisë së kërkimit. Kjo garanton se kandidati do të punojë me efektivitet.
- e) Të garantojë kandidatin se është në lidhje me specialistin e duhur nëse kërkimi i kandidatit kryhet në një fushë tjetër nga ajo e udhëheqësit.
- f) Në rastet kur këshilli i profesorëve vendos një bashkudhëheqës përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta.
- g) Të vlerësojë progresin e kandidatit rregullisht duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë kandidatin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
- h) Të mbajë një skedë me shënimë për progresin e kandidatit.
- i) Të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar kandidatin në përgatitjen e punës së tij, që do të prezantohet në seminare ose takime.
- j) Të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar kandidatin për përgatitjen e prezantimit të punimit të tij para Këshillit të Profesorëve.
- k) Të bëjë kritikat e duhura për punimin e kandidatit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së disertacionit të konfirmojë se kërkimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e gradës shkencore "Doktor".
- l) Të vërtetojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e Këshillit të Profesorëve, kur ai e ka kthyer punimin përi riparaqitje.
- m) Të nxisë kandidatin që ai të botojë pjesë nga kërkimi i tij.
- n) Të menaxhojë fondet e kërkimit nëse janë siguruar të tillë.

Neni 32

Përgjegjësitë e Këshillit të Profesorëve

- a) Të hartojë udhëzimet e procedurave të përgatitjes dhe të mbrojtjes së disertacionit.
- b) Të hartojë çdo vit një listë me temat që kanë nevojë për studim, të cilat u bëhen të ditura kandidatëve që me fillimin e kursit.
- c) Të garantojë se temat e propozuara janë të përshtatshme për fitimin e diplomës.
- d) Të kujdeset se të gjithë kandidatët kanë udhëheqësin e kërkimit.
- e) Të respektojë rregullat për caktimin e udhëheqësit shkencor të disertacionit. Si rregull, udhëheqës i disertacionit caktohet një pedagog i Universitetit të Gjirokastrës, ose i një universiteti tjetër që



mban titullin "Profesor", "Profesor i Asocuar", gradën "Doktor" (Ph.D. në universitetet perëndimore), një studiues me titullin "Drejtues kërkimesh", "Mjeshtër kërkimesh", që është njoħes i mirë dhe kontribuuves i fushës nga e cila është marrë tema që ai ngarkohet të udhëheqë.

- f) Të garantojë se udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës së kërkimit, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij.
- g) Të garantojë se udhëheqësit e disertacioneve nuk janë të mbingarkuar me udhëheqje diplomash të tjera.
- h) Të përcaktojë numrin maksimal të udhëheqjeve për një pedagog.
- i) Të miratojë temat dhe udhëheqësit e punimeve të disertacionit.
- j) Të garantojë se kandidatët i kanë mundësitet dhe lehtësirat e duhura për të realizuar kërkimin.
- k) Të interesohet për t'u siguruar kandidatëve konsulencën e nevojshme.
- l) Të garantojë se politikat e udhëheqjes së kërkimit janë respektuar.
- m) Të garantojë se për zhvillimin e disertacionit zbatohen standartet e kërkimeve shkencore.
- n) Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga kandidatët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t ka/kanë kontakt të rregullt me kandidatin. Në rastet kur ka probleme Këshilli i Profesorëve vëzhgon ecurinë dhe i propozon Dekanit të FEShSh-së ndryshimet zyrtare të mundshme.
- o) Të garantojë se procedura e mbikëqyrjes dhe e shqyrtimit të ecurisë së kërkimit është e rregullt.
- p) T'ua bëjë të njobura udhëzimet përkatëse të gjithë kandidatëve.
- q) Të përgatisë manualin e disertacionit.

Neni 33

Përgjegjësitet e kandidatit

- a) Të jetë i familjarizuar me rregullat e procedurave të disertacionit.
- b) Sapo të ketë përcaktuar fushën e kërkimit, ai duhet të kërkojë një udhëheqës si rregull nga stafi akademik ose nga bashkëpunëtorët e fakultetit përkatës.
- c) Të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për disertacionin.
- d) Të punojë fort dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për të përfunduar disertacionin në kohën e duhur.
- e) Kandidati duhet t'i paraqesë nëpermjet udhëheqësit Këshillit të Profesorëve një raport të punës së kryer çdo muaj.

Neni 34

Përgjegjësitet e koordinatorit



Përgjegjësi i Projektit DShA ose koordinatori është autoriteti drejtues i FEShSh-së. Ai përgjigjet për përbushjen e misionit të Programit DShA dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtarinë e gjithanshme të saj.

- a) Emërohet në detyrë nga Rektori i UGj-së në bazë të propozimit të Këshillit Shkencor dhe Dekanit të FEShSh-së, për një periudhë prej 4 vjetësh, ku propozohet çdo vit. Qëndrimi i mëtejshëm i përgjegjësit në detyrë varet nga vlerësimi i Këshillit Shkencor dhe angazhimi i përgjegjësit.
- b) Drejton punën për hartimin, ndryshimin e rregullores së projektit; për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit; për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik të shkollës: planin mësimor, programet mësimore, paketën e praktikës dhe të udhëzimeve për disertacionin; për administrimin e të ardhurave të shkollës.
- c) Harton çdo vit një listë me temat që duhen studiuar;
- ç) Të kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqës shkencor. Të respektojë rregullat për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës.
- d) Të garantojë se udhëheqësit e temave nuk janë të mbingarkuara me udhëheqje diplomash.
- dh) Përgatit punën për miratimin e programet mësimore.
- e) Drejton hartimin e orarit të mësimeve, të provimeve dhe ndjek zbatimin e tyre.
- f) Nge komisionet e provimeve.
- g) Ndjek ecurinë e procesit mësimor.
- h) Ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe të procesit të disertacionit.
- i) Organizon ceremoninë e diplomimit.
- j) Organizon dokumentacionin e konkursit të pranimit të kandidatëve të rinj për Programin DShA.
- k) I propozon Këshillit të Profesorëve kriteret e pranimit dhe kandidaturat e personelit akademik dhe të personelit ndihmës të projektit.
- l) Nënshkruan kontratën me personelin akademik dhe administrativ.
- m) Organizon takime pune 2 herë në vit me personelin akademik.
- n) Përgatit për dekanin akte dhe shkresa zyrtare në emër të programit.
- o) Ndjek ecurinë e botimeve.
- p) Ndjek bashkëpunimin me partnerët.
- q) I propozon dekanit masat ndëshkimore për pedagogët dhe studentët-kandidatë që shkelin rregulloren.
- r) Përfaqëson, me lejen e dekanit, projektin në marrëdhëniet me të tretët.
- s) Organizon vlerësimin e brendshëm të programit.
- t) Vlerëson punën e pedagogëve dhe të asistentit.
- u) I paraqet çdo vit mësimor raportin e veprimtarisë së Programit DShA Këshillit Shkencor të FEShSh-së.



Neni 35

Planifikimi i studimit të doktoratës

Planifikimi i studimit të doktoratës kryhet nga studenti dhe i propozohet udhëheqësit të tij planin e studimit, që përmban:

- a) Listën e lëndëve të detyruara për t'u studuar;
- b) Listën e lëndëve që ai e formon vetë;
- c) Mënyrën e vlerësimit të studimit të tyre;
- d) Literaturën që do të studiohet në kuadër të studimit, platformën shkencore të studimit doktoral

Ky plan studimi i shkon për shqyrtim Këshillit të Profesorëve dhe pas miratimit të tij merr formë përfundimtare.

Neni 36

Platforma e studimit të doktoratës

36.1. Studenti doktorant harton së bashku me udhëheqësin shkencor një platformë studimi që ai do ta realizojë. Kjo platformë kalon për miratim në Këshillin e Profesorëve të FEShSh-së. Kolegjin e miraton ose bën rekomandime për përmirësimin e saj. Kopja e miratuar e platformës depozitohet në dosjen e studentit të zgjedhur, e firmosur nga Këshilli i Profesorëve.

36.2. Struktura e platformës së studimit doktoral është si më poshtë:

- a) Formulimi i problemit që do të studiohet;
- b) Analizë e bazës teorike që ka lidhje me problemin që do të studiojë studenti doktorant;
- c) Analizë koncize e studimeve të kryera në lidhje me problemin që do të studiojë studenti doktorant;
- d) Pjetjet të cilave studimi do t'u japë përgjigje;
- e) Nëse ka, cilat janë hipotezat e studimit;
- f) Një përshkrim i shkurtër i rëndësisë së studimit përfshirë fushën e gjuhës;
- g) Metodologjia e kërkimit (e përfshirë).

36.3. Në dosjen e doktoratës dhe në platformën e studimit të përfshihet diznjimi i kërkimit, përfshirë edhe strukturën e përgjithshme të studimit.

Neni 37

Komisionet



Për nevojat e Projektit DShA ngrihen komisione të ndryshme që kryejnë detyra të caktuara lidhur me zhvillimin e provimeve, me përgatitjen dhe mbrojtjen e disertacionit, me strategjinë e zhvillimit të shkollës, etj. Komisionet propozohen nga përgjegjësi i Projektit DShA dhe miratoohen nga dekani.

Neni 38 **Personeli akademik**

- a) Personeli akademik përbëhet nga profesorati që zhvillon mësim në programin DShA.
- b) Në programin DShA pranohen pedagogë që zotërojnë titullin “profesor”, “profesor i asocuar”, që zotërojnë gradën “doktor” në universitetë perëndimore (Ph.D.).
- c) Pranimi i pedagogëve bëhet sipas kritereve të miratuara nga Këshilli Shkencor i FEShSh-së.
- ç) Pedagogët e huaj pranohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.
- d) Për çdo vit mësimor pedagogët nënshkruajnë një kontratë pune me përgjegjësin e programit DShA ku janë parashikuar detyrimet e pedagogut, angazhimet e shkollës dhe shpërblimi i tij.
- e) Të drejtat dhe përgjegjësitë e pedagogëve.
- f) Të kenë në dispozicion gjithë informacionin e nevojshëm për realizimin e detyrave të tyre.
- g) Të përdorin të gjitha mjediset dhe pajisjet e shkollës për veprimitari në dobi të shkollës.
- h) Të përfaqësohen në organet drejtuese të FEShSh-së për problemet e programit DShA.
- i) Të marrin pjesë në komisione dhe veprimitari të ndryshme të shkollës.
- j) Të kualifikohen në kuadrin e projekteve të shkollës. Të zbatojnë kontratën e punës.
- k) Të zbatojnë Rregulloren e FEShSh-së dhe të UGj-së.
- l) Të bashkëveprojnë në një mënyrë profesionale, qytetare me kolegët, studentët dhe bashkëpunëtorët e shkollës.
- m) Të realizojnë programin mësimor sipas kërkesave të paracaktuara.
- n) Të krijojnë një klimë bashkëpunimi me studentët dhe kolegët.
- o) Të përmbushin përgjegjësitë për udhëheqjen e disertacionit.
- p) Të kontribuojnë në çështjet e integrimit evropian të shkollës dhe vendit.
- q) Të vlerësojnë studentët në mënyrë profesionale dhe në kohën e parashikuar.
- r) Të mos marrin pjesë në një komision vlerësimi të studentëve kur ata kanë lidhje familjare me ndonjë prej tyre.
- s) Të mos angazhojnë studentët për punë vetjake.

Neni 39 **Asistenti dhe sekretaria mësimore e DSHA-së**

Asistenti dhe sekretari i Programit DShA kryen detyrat si më poshtë:



- a) Punon nën drejtimin e përgjegjësit të Projektit DShA dhe mban përgjegjësi për zbatimin e të gjitha porosive të dhëna prej tij për komunikimin shkresor e gojor me Dekanin e FEShSh-së, Këshillin Shkencor, me personelin akademik, me studentët, me bashkëpunëtorët e shkollës.
- b) Bën organizimin teknik të mbledhjeve të Këshillit Shkencor dhe mban procesverbalin e mbledhjeve.
- c) Ndihamon në përgatitjen e materialeve për përgjegjësin e programit DShA.
- d) Shërben në protokollin e organizuar në shkollë për delegacione zyrtare shqiptare ose të huaja.
- e) Pret personat që kërkojnë takim me përgjegjësin.
- f) Merr në dorëzim korrespondencën dhe materiale të tjera që vijnë në adresë të përgjegjësit të programit DShA.
- g) Arkivon dokumentacionin e shkollës, të pedagogëve dhe të studentëve.
- h) Shtyp dhe shumëfishon shkresa dhe materiale mësimore.
- i) Kryen procesin e regjistrimit të studentëve të rinj gjatë procesit të konkursit të pranimit si dhe procedurën e regjistrimit të studentëve të pranuar.
- j) Ndjek ecurinë e procesit mësimor në drejtim të respektimit të strukturës mësimore, të orarit të mësimit, të provimeve; ecurinë e praktikës, të procesit të mikrotezës dhe kujdeset për mbajtjen e dokumentacionit përkatës të këtyre proceseve.
- k) Përgatit mjetet mësimore për zhvillimin e procesit mësimor.
- l) Bën pajisjen me kancelari e materiale të tjera të domosdoshme që i duhen shkollës.
- m) Afishon strukturën mësimore, orarin e mësimit, datat e provimeve, datat e praktikës, të mbrojtjes së mikrotezave dhe lajmërimë për veprimtari të ndryshme.
- n) Merr në dorëzim procesverbalet e plotësuara të vlerësimeve.
- o) U jep informacion për vlerësimin studentëve.
- p) Pajis të gjithë studentët e rinj të pranuar në DShA me librezë notash dhe kartë studenti, plotëson kërkesat e studentëve për vërtetimë të thjeshta, listë notash e dokumente të tjera.
- q) Kryen hedhjen e notave në regjistrin themeltar sipas kurseve dhe lëndëve; përgatit diplomat dhe certifikatat e notave për studentët që mbarojnë studimet.
- r) Mban lidhje me degën mësimore në Rektorat dhe raporton të dhënrat statistikore të Projektit DShA në instancat që i kërkojnë.
- s) Kryen shërbimet të internetit.
- t) Ka në ngarkim pajisjet e shkollës.
- u) Merr masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit nga rreziqet e ndryshme si zjarri, uji, dëmtimet, shpërdorimet, etj.
- v) Në fund të vitit akademik përgatit një raport pune të cilin ia paraqet përgjegjësit të shkollës.



KREU X

AFATI I PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS PARAQITJA PUBLIKE, ETIKA DHE TEZA E STUDIMIT

Neni 40

Afati i mbrojtjes së disertacionit

- a) Afati i mbrojtjes së disertacionit është tre vjet pa shkëputje nga puna, por afati maksimal nuk duhet të kalojë pesë vjet nga regjistrimi në program. Për arsyet përligjura (sëmundje të rënda, fatkeqësi etj.) kandidati mund t'i kërkojë KP të FEShSh-së shtyrjen e afatit të përfundimit të studimeve të doktoratës, duke paraqitur dhe dokumentuar edhe arsyet e kësaj shtyrje.
- b) Dy vitet e para të studimeve doktorale shpenzohen për marrjen e disa lëndëve, për studimin e literaturës, për kërkimet në terren. Ndërsa në vitin e tretë për analizën e gjetjeve dhe shkrimin e studimit të doktoratës.
- c) Për studentët që janë marrëdhënie pune do të ndiqen afatet e përcaktuara në Udhëzimin e MASH-it nr. 5, datë 22.01. 2008 “Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës si dhe të elementeve bazë sipas të cilave IAL duhet të përgatisin rregulloren përkatëse”.

Neni 41

Paraqitja publike e rezultateve të punës

- 41.1. Studenti i doktoratës paraqet publikisht dy pjesë të punimit të tij doktoral në mbledhjen e departamentit të gjuhës shqipe, departamentit të letërsisë ose të departamentit të historisë.
- 41.2. Studenti i doktoratës ka detyrim të batojë dhe të prezantojë punimet e tij në lidhje me kërkimin doktoral dhe në nivele ndërkombëtare sipas udhëzimeve në fuqi, të pasqyruara edhe në këtë rregullore (shih neni 25)
- 41.3. Studenti i regjistruar në programin e doktoratës paraqitet para Këshillit të Profesorëve në një provim paraprak, i cili bazohet në verifikimin e punës së studentit doktorant. Forma e këtij provimi paraprak përcaktohet nga Këshilli i Profesorëve.

Neni 42

Etika e studimit të doktoratës



Studenti i doktoratës i përbahet etikës më të lartë të kërkimit dhe prodhimit shkencor. Ata respektojnë rregullat e mirënjojura për respektimin e autorësisë, të moskomplikimit e të plagjiaturës. Shkeljet në këtë drejtim marrin ndëshkimin më të ashpër të ndërprerjes së studimeve doktorale.

Neni 43

Teza e studimit doktoral

43.1. Tezë e studimit të doktoratës konsiderohet titulli i kërkimit që studenti doktorant do të hartojë. Ajo si rregull, përsaqëson sipërmarrjen e kryerjes së një studimi për vërtetimin e një teze të caktuar të pavërtetuar më parë, për hedhjen poshtë të një teze të njojur, ose për të modifikuar një tezë të propozuar më parë.

43.2. Për kryerjen me sukses të tezës jepen udhëzime të hollësishme që përfshijnë edhe formatin e saj.

43.3. Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së tezës studenti i doktoratës duhet të marrë vlerësimë mbi mesataren në të gjitha lëndët e caktuara, të ketë kaluar në nivelin mbi notën tetë në provimin paraprak dhe të ketë plotësuar në rregull dokumentacionin.

KREU XI

FORMIMI DHE FUNKSIONIMI I JURISË PËR MBROJTJEN E DOKTORATËS

Neni 44

Përbërja e jurisë për mbrojtjen e disertacionit

44.1. Mbrojtja e doktoratës bëhet prej një jurie të përbërë nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 janë anëtarë të stafit akademik të departamentit përkatës dhe 3 anëtarë të jashtëm, të gjithë me tituj shkencorë. Anëtarët e jurisë mund të janë edhe nga universitete të tjera brenda ose jashtë vendit. Njëri nga anëtarët e jurisë është kryetar, ndërsa 2 prej anëtarëve të jurisë janë oponentë.

44.2. KP i dorëzon Dekanit të FEShSh-së jurinë për mbrojtjen e doktoratës, mbi bazën e propozimit të njësisë bazë.

44.3. Vendimin për miratimin e jurisë e merr Dekani i FEShSh-së, sipas propozimit të KP.

Neni 45

Juria, oponanca dhe koha që duhet për mbrojtjen e doktoratës

45.1. Mbrojtja e doktoratës bëhet me pjesëmarrjen e plotë të jurisë jo më parë se 1 muaj nga data e miratimit të saj.

45.2. Oponentët jepin vlerësimin me shkrim të disertacionit në jo më pak se 4 faqe format A-4 ku saktësohet se punimi në tërësi i përmbush kërkesat e paraqitura në programin e doktoratës, duke i



kushtuar vëmendje vlerave origjinale që paraqet punimi si dhe duke u vënë në dukje anët pozitive e negative të tij (nëse ka).

45.3. Kur për arsyen të përligjura një anëtar i jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, përgjegjësi i departamentit (të gjuhës shqipe, i departamentit të letërsisë e historisë) vë në dijeni Dekanin e FEShSh-së, duke i propozuar edhe një datë tjeter për mbrojtje. Dekani vë në dijeni KP. Dekani merr vendimin për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas miratimit paraprak të KP-së.

45.4. Në rast të mospranimit të disertacionit, studenti duhet të lajmërohet me shkrim nga Dekani i FEShSh-së mbi vendimin e marrë. Në rast pranimi procedura vazhdon më tej.

KREU XII

MBROJTJA, VLERËSIMI, GRADIMI DHE PEZULLIMI I STUDENTËVE DOKTORANTË

Neni 46

Mbrojtja e tezës doktorale

44.1. Mbrojtja e tezës së doktoratës bëhet nga Këshilli i Profesorëve të FEShSh-së. Mbrojtja e tezës është publike dhe në të mund të marrin pjesë personat e interesuar.

44.2. Procedurat e mbrojtjes së disertacionit përfshin:

- a) Paraqitjen nga kryetari i dokumentacionit të dosjes, përbërjen e jurisë dhe deklarimi nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes;
- b) Paraqitja e temës së disertantit për një kohë prej 25-30 min;
- c) Paraqitja e oponencave;
- d) Pyetje nga të pranishmit rrëth disertacionit dhe oponencave drejtuar studentit disertant ;
- e) Diskutime ;
- f) Sqarime e replika të mundshme nga studenti doktorant dhe udhëheqësi shkencor ;
- g) Shpërndarja e fletëve të votimeve të hapura e të paplotësuara dhe votimi i fshehtë për vlerësimin e doktoratës;
- h) Pasqyrimi në procesverbal i rezultatit të votimit dhe shpallja e vendimit me shkrim.

Neni 47

Vlerësimi

- a) Studimi i doktoratës vlerësohet me 50 pikë. Nga 41-50 pikë vlerësohet shumë mirë; 35-40 pikë vlerësohet mirë, 25-34 pikë vlerësohet mjaftueshëm dhe nën 25 pikë vlerësohet pakalues.
- b) Dhënia e pikëve është nga komisioni i vlerësimit është e fshehtë.



- c) Rrëzimi i studimit doktoral i mundëson studentit të paraqitet sërisht për mbrojtje vetëm pas një viti.

Neni 48

Dokumentacioni i vlerësimeve

- a) Të gjitha operacionet për mbrojtjen e studimit të doktoratës dokumentohet dhe dokumentacioni ruhet.
- b) Në asnjë rast dokumentacioni në lidhje me vlerësimin e studentit doktorant nuk duhet të përbajë korrigjime.
- c) Pas mbrojtjes së doktoratës, autori dorëzon menjëherë një kopje të disertacionit të tij në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në Bibliotekën Shkencore të FEShSh-së (ku u krye mbrojtja) dhe një kopje në Bibliotekën Shkencore të UGj-së, përkundrejt pajisjes me vërtetim për depozitimin e tyre. Në të kundërt autorit nuk i dorëzohet diploma përkatëse.

Neni 49

Gradimi

49.1. Për të fituar gradën shkencore «Doktor i shkencave albanologjike» studenti doktorant duhet të përbushë këto kushte :

- a) Marrje mbi nivelin mesatar të kurseve të detyruara dhe me zgjedhje të programit;
- b) Dëshmi ndërkontakt (të paktën niveli C1) i njohurisë për gjuhën angleze;
- c) Rezultati mbi notën tetë në provimin paraprak;
- d) Përfundimi dhe mbrojtja e suksesshme gojore e tezës së disertacionit;
- e) Përbushja e kërkeseve për prezantime në departament dhe botime sipas udhëzimeve në fuqi.

49.2. Gradimi «Doktor i shkencave albanologjike » bëhet në çastin kur studenti doktorant kalon provën e mbrojtjes së tezës.

49.3. Pas realizimit me sukses të mbrojtjes së doktoratës, doktoranti merr gradën shkencor «Doktor i shkencave albanologjike», diploma firmoset nga Dekani i FEShSh-së dhe Rektori UGj-së.

49.4. Në rast kthimi imbrapsht nga juria, punimi mund të paraqitet vetëm një herë tjetër përpëra së njëjtës juri, jo më parë se 12 muaj nga data e rrëzimit. Për arsyet përligjura si arsyet shëndetësore, fatkeqësi familjare të studentit doktorant, mbështetur në kërkesën e tij, KP mund të zgjatë periudhën e mbrojtjes jo më shumë se 12 muaj.

Neni 50

Pezullimi i procedurës së mbrojtjes së doktoratës



50.1. Nëse doktoranti heq dorë nëpërmjet një sqarimi me shkrim drejtuar Dekanit të FEShSh-së nga vazhdimi i mëtejshëm i procedurës atëherë mbrojtja konsiderohet e pezulluar. Dekani i FEShSh-së informon KP dhe udhëheqësin shkencor mbi pezullimin e procedurës. Në këtë rast është e mundur përsëritja vetëm një herë e procedurës, duke marrë parasysh arritjet e doktorantit deri në stadin aktual të procedurës.

50.2. Procedura e doktoratës do të pezullohet edhe në rastet kur udhëheqësi shkencor jep dorëheqje për arsyе të përligjura, si: arsyе shëndetësore, për rezultatet e pakënaqshme të disertantit, pavarësisht punës së udhëheqësit etj.

Neni 51

Shfuqizimi i gradës «Doktor»

51.1. Nëse pas mbrojtjes së disertacionit, konstatohet dhe vërtetohet se grada «Doktor» është e mbrojtur nëpërmjet falsifikimeve ose rrugëve joligjore, atëherë grada shfuqizohet.

51.2. KP i FEShSh-së ngre një juri tjetër, e cila merr vendimin për shfuqizimin.

51.3. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, i duhet dhënë mundësi personit që preket prej vendimit të sqarojë pozitë

KREU XIII

STRUKTURA E PUNIMIT SHKENCOR (DISERTACIONIT)

Neni 52

Pjesët përbërëse të disertacionit

Punimi shkencor ose disertacioni duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:

- Abstrakti
- Mirënjojja
- Tabela e përmbajtjes
- Studimi
 - Hyrja
 - Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes
 - Shqyrtimi i materialit të vjetër dhe qëndrimi vetjak
 - Përfundime
 - Bibliografia
 - Shtojca



Neni 53

Përshkrim i shkurtër i pjesëve të studimit

1. Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse formati nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.
2. Tri kopje të punimit shkencor të janë origjinale. Disertanti përgatit edhe 20 kopje autoreferate, nga të cilat anëtarët e jurisë marrin nga 1 kopje.
3. Disertacioni duhet të realizojë këto anë teknike:
 - 3.1. Abstrakti. Çdo punim duhet të përbajë një abstrakt. Abstrakti duhet të jetë një përbledhje që paraqet pikat kryesore dhe përfundimet e punimit. Abstrakti duhet të vendoset para falënderimeve dhe tabelës së përbajtjes. Abstrakti nuk duhet t'i kalojë 350 fjalët.
 - 3.2. Mirënjoja. Duhet paraqitur mirënjoja për të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e punimit dhe financimin e tij.
 - 3.3. Tabela e përbajtjes. Në këtë seksion paraqitet tabela e përbajtjes me elementet e strukturës së punimit, titujt përkatës dhe numrin e faqeve për secilin element.

4. Studimi. Studimi, përgjithësish, duhet të ketë këtë format:

- 4.1. Hyrja. Seksioni i hyrjes duhet të prezantojë fushën e studimit, çështjen e marrë në studim, detyrën shkencore, të përbledhë informacionin e rëndësishëm dhe strukturën e punimit.

Lista e shtojcave

Në këtë seksion paraqiten vetëm listat e tabelave, ilustrimeve, shtojcave të përdorura në punim. Ky seksion përfshihet nëse tema jep mundësi për përdorimin e tabelave, ilustrimeve, shtojcave.

4.3. Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes. Në këtë pjesë paraqiten kontributet e studiuesve të ndryshëm për çështjen e marrë në studim.

4.4. Shqyrtimi i materialit të mbledhur dhe qëndrimi vetjak i doktorantit.

4.7. Përfundime. Ky seksion përbledh gjetjet kryesore të studimit.

4.8. Propozime të tjera. Ky seksion nuk është i detyrueshëm dhe kërkohet vetëm nëse rezultatet justifikojnë kërkimin e mëtejshëm.

4.9. Bibliografia. Të gjitha punimet shkencore duhet të përdorin literaturën dhe për citatet të tregojnë burimin e tyre. Seksioni i bibliografisë duhet të vendoset në faqe më vete.

4.10. Shtojcat. Ky seksion përmban ilustrime shtesë, të dhëna e shifra origjinale që janë shumë të gjata për t'u përfshirë në tekston. Ato përfshihen në "Shtoja" në mënyrë që të mos e shkëpusin lexuesin nga diskutimet origjinale. Shtojcat mund të ndahen në sekcione. Secila shtojcë ka titullin e vet dhe mund edhe të paraqitet veçmas në faqen e tabelës së përbajtjes.

Në këtë rubrikë përfshihen materiale të tillë plotësuese si: instrumente të ndryshme të kërkimit të përdorura në studim, pyetësorë, intervista, harta, dokumente ligjore, historike, seri fotografish etj.



Të gjithë kapitujt, çështjet, rubrikat e studimit renditen me rend numerik.

KREU XIV

KËRKESA TEKNIKE PËR PUNIMIN SHKENCOR

Neni 54

Paraqitura teknike e disertacionit

1. Format. Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kerkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

2. Lidhja. Tri kopje të punimit shkencor duhet të lidhen. Njëra prej kopjeve duhet të jetë origjinalja. Në kopertinë duhet të vendoset emri i Universitetit të Gjirokastrës, i Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, i programit, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes. Sfondi i kopertinës së punimit duhet të jetë të përbajë: Disertacioni shoqërohet me një përbledhje rreth 10 faqe në gjuhën angleze. Përdoret madhësia 10-she e shkronjave. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve të kuptojnë se si është trajtuar çështja e marrë në studim.

Fushën dhe fjalët kyçë. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçë në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.

3. Gjatësia e punimit. Pjesa e studimit shkencor për diplomën “Doktor i shkencave albanologjike” përcaktohet nga KP. Si rregull duhet të ketë jo më pak se 120 dhe jo më shumë se 160 faqe kompjuterike. Referencat, shënimet në fund të faqes, shtojcat, tabelat, diagramet nuk përfshihen në këtë përllogaritje.

Vendi që zënë elementet e punimit:

Hyrja 10 %

Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes 30%

Shqyrtimi i materialit të mbledhur dhe qëndrimi vetjak 45%

Përfundime -10%

Bibliografia – 5%

Për të llogaritur kufirin e fjalëve dhe të faqeve rekomandohet metoda e mëposhtme e llogaritjes: maksimumi 2310 karaktere për faqe për punimin e mikrotezës



numri i karaktereve llogaritet duke përfshirë hapësirën, pikësimin në një radhë dhe shumëzohet me numrin e radhëve

në një radhë do të ketë 70 karaktere me një maksimum prej 33 radhësh.

4. Lloji i letrës. Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.

5. Shtypja. Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Të gjitha kopjet e studimit duhet të janë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të janë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.

6. Cilësia e shtypjes. Teksti duhet të shtypet me hapësirë një e gjysmë ndërmjet radhëve. Hapësira njëshe do të përdoret për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë. Vetëm një lloj shkrimi duhet përdorur. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times Neë Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she.

7. Margjinat. Margjinat për të gjithë tekstin do të janë

Margjina e sipërme: 1 “

Margjina e poshtme: 1 “

Margjina e majtë: 1.25 “

Margjina e djathtë: 1.25 “

8. Numrat e faqeve. Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.

Hyrja duhet të ketë numra romakë.

Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.

Faqet e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrave të tekstit.

9. Shënimet. Në shkencat humane përdoren gjerësisht shënimet. Studentët këshillohen të përdorin referanca të botimeve të ndryshme të fushës, të raporteve ose të disertacioneve të kandidatëve të suksesshëm të cilat mund të gjenden në biblioteka. Madhësia e shkronjave të shënimeve është më e vogël se ajo e tekstit. Shënimet në fund ta faqes si dhe të gjitha llojet e tjera të shënimeve duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she.

10. Materialet shoqëruese. Nëse një punim përbën materiale shoqëruese të tilla, si: disketa kompjuteri, video ose kaseta, etj.. që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t'i bashkëngjiten punimit.

KREU XV

ETIKA E KËRKIMIT



Neni 55

Kërkesat etike për punën e disertacionit

1. Studimi duhet të jenë punë originale e kandidatit.
2. Një kandidat nuk lejohet të paraqesë si punim për diplomën master një punim që e ka paraqitur për një gradë tjeter në këtë universitet ose në një universitet tjeter, por kandidati nuk ndalohet të përfshijë pjesë të punës nëse ai tregon qartë cila pjesë e punës është përdorur më parë.
3. Një kandidat mund të paraqesë një pjesë kontributi që është botuar më parë individualisht ose në grup. Nëse puna është pjesë e përpjekjeve të një grupei, një shpjegim për pjesën e shkruar nga kandidati duhet të përfshihet në punim.
4. Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit shkencor, kandidati mund të batojë pjesë të studimit shkencor me lejen e udhëheqësit.
5. Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjeter pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të të tjerëve.
6. Përdorimi i ideve ose i punës së të tjerëve duhet të evidencoitet individualisht në tekstu ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.
7. Të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe të shënohet burimi.
8. Nëse pasazhet e marra nga të tjerët janë më të gjata se pesë radhë nuk fuqen në thonjëza, por shënohet referenca për to.
9. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore.
10. Nëse burimi original nuk gjendet dot, por burimi është përmendur në një dokument tjeter, atëherë të dy dokumentet, burimi original dhe burimi dytesor duhet të jepen.
11. Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por përkundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme. Pandershmëria akademike e cila përfshin deklarime false, të dhëna të rreme, prezantimi i punës së grüpuit si punë individuale dhe plagjiatura i duhen shpjeguar studentit. Megjithatë, rastet e mosrespektimit të rregullave të citimeve për shkak të pakujdesisë ose të mosdijes do të dallohen nga ato ku pandershmëria është e dukshme dhe e qartë.
12. Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore për veprime të mëtejshme.
13. Pronësia intelektuale. Është drejta e autorit për punimin (si edhe për një material të botuar) mbrohet nga ligji ndërkombëtar i së drejtës së autorit. Shënim i përmendur është rezervimin e së drejtës së autorit, simboli përkatesë ©, emri i zotërueshit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendoset në faqen që vjen pas titullit të punimit.



KREU XVI
FINANCIMI I STUDIMEVE

Neni 56

Burimi i financimit

56.1. Programi “Doktor në shkencat albanologjike” financohet nga shteti dhe nga vetë studentët. Të ardhurat e saj formohen nga tarifa e shkollimit e paguar nga studentët, taksa e regjistrimit dhe nga të ardhurat e tjera të ligjshme.

56.2. Programi DShA ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin e veprimtarisë së saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 57

Administrimi i të ardhurave

Administrimi i të ardhurave bëhet në bazë të vendimeve zyrtare, Këshillit të Ministrave, të udhëzimeve të MASH dhe Ministrisë së Financave, Vendimeve të këshillit Administrativ dhe të Senatit Akademik të UGj-së si dhe të Këshillit të Profesorëve

Neni 58

Tarifa e shkollimit

58.1. Tarifa e shkollimit për Programin e Ciklit të Tretë nga këshilli i profesorëve dhe nga vendimet zyrtare.

58.2. Tarifa e shkollimit paguhet me këste sipas vendimit të Zyrës së Financës të UGj-së. Pagesa bëhet pranë zyrës së llogarisë së UGj-së. Studentit i jepet një fletëpagesë.

58.3. Detyrimi i studentëve për tarifën e shkollimit të Programit DShA shprehet në Rregulloren e Brendshme të Programit DShA-së. Studenti është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës së shkollimit në datën e caktuar. Studentit që nuk kryen pagesën e tarifës së shkollimit në datën e caktuar detyrohet të paguajë një gjobë. Të përcaktuar nga zyra e financës.

58.4. Taksa e regjistrimit për konkursin e pranimit është 5 000 lekë.

Secili kandidat që dëshiron të regjistrohet për konkursin e pranimit në Programin DShA duhet të paguajë në ditën e regjistrimit një taksë të caktuar nga drejtoria e financës. Kjo taksë regjistrimi është e pakthyeshme për kandidatët që nuk fitojnë të drejtën e studimit. Fletëpagesa e taksës së regjistrimit duhet të shoqerojë dokumentin e aplikimit dhe të përfshihet në dosjen e kandidatit.

48.5. Përdorimi i të ardhurave nga tarifa e shkollimit dhe taksa e regjistrimit.

a) Përdorimi i të ardhura kryhet sipas Vendimin Nr. 319, datë 15.05.2003 të Këshillimit të Ministrave, udhëzimit nr. 4 datë 4. 2. 2003 të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe vendimeve të Këshillit Drejtues të UGj-së.



b) Përfitimi i studentëve nga pagesa e kursit përfshin: dokumentet zyrtare për ta, shfrytëzimin e bibliotekës, të qendrës së dokumentacionit, të internetit dhe pajisjet e tjera teknike dhe elektronike të shkollës. Pagesa nuk përfshin shpenzimet për tekste, fotokopjim materialesh, për vizita studimore, praktikë.

KREU XVII **MARRËDHËNIET ME PARTNERËT**

Neni 59

- a) Programi DShA institucionalizon marrëdhëniet me bashkëpunëtorët. Si bashkëpunëtorë mund të janë institucionë e organizma publikë dhe privatë si dhe individë me veprimtari në fushën e arsimit dhe të integrimit evropian të arsimit.
- b) Bashkëpunimi i Programit DShA me institucionet dhe individët kryhet mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit të negociuara nga shkolla dhe të nënshkruara nga Rektori i UGj-së.
- c)

KREU XVIII **VLERËSIMI I PROGRAMIT DshA**

Neni 60

- a) Programi DShA kryen çdo dy vjet vlerësimin e brendshëm.
- b) Shkolla kërkon akreditimin në afatet e parashikuara me ligj.

KREU XIX **MASAT DISIPLINORE**

Neni 61

- a) Shkelje e rregullave ndaj Programit DShA quhen të gjitha veprimet e kryera nga ana e subjekteve që veprojnë në shkollë dhe që cenojnë personalitetin e subjekteve të tjera që veprojnë në shkollë.
- b) Si veprime të ndëshkueshme quhen falsifikimi i dokumenteve të ndryshme, kopjimi në provime, plagiatura në punime shkencore, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes, shkelja e rregullores etj.
- c) Ndaj personave që kryejnë këto veprime merren këto masa disiplinore:
 - a) Vërejtje me shkrim b) përjashtim nga shkolla për një vit c) përjashtim nga Universiteti i Gjirokastër, d) gjoba.



- d) Masat e parashikuara në pikat a), c) dhe d) merren nga Dekani i FEShSh-së. Masa b) merret nga Rektori i UGj-së.
- e) Asnjë ndëshkim nuk mund të zbatohet pa u dëgjuar më parë personi që do të ndëshkohet.
- f) Ndëshkimet e dhëna nga Dekani mund të kundërshtohen në Këshillin e Disiplinës.
- g) Vendimet e Këshillit të Disiplinës mund të ankimoren pranë Rektoratit brenda pesë ditëve nga dita e komunikimit të tyre. Ankimi i bërë nuk pezullon zbatimin e masës.

KREU XX
VULA ZYRTARE DHE LOGO E SHKOLLËS

Neni 62

Programi DShA ka vulën zyrtare të FEShSh-së sipas modelit të miratuar nga organi kompetent.

Neni 63

Të drejtën e vulës zyrtare të Programit DShA e ka Dekani i FEShSh-së.

KREU XXI
DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 64

Kjo rregullore mund të përsoiset e të korrigohet gjatë punës në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër Programi DShA ose ndryshimet në strukturën e administratës, me anë të amendamenteve të ndryshme bashkëngjitur asaj me firmën e Dekanit të FEShSh-së së UGj-së ose duke u ripunuar tërësisht. Një kopje e kësaj rregulloreje depozitohet në protokoll.

Neni 65

Kjo rregullore hyn në fuqi duke filluar nga viti akademik 2012-2013.

